LIGJ
Nr. 66/2013

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8702, DATË 1.12.2000 "PËR IDENTIFIKIMIN DHE REGJISTRIMIN E KAFSHËVE DHE TË FERMAVE BLEGTORALE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8702, datë 1.12.2000 "Për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve dhe të fermave blegtorale", bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

Organ kontrolli është veterinari zyrtar, në përputhje me legjislacionin në fuqi "Për Shërbimin Veterinar".".

Neni 2

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 9

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, veterinari zyrtar vendos dënimin kryesor me gjobë, në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" si më poshtë:

a) Për shkeljet e parashikuara në nenin 8 shkronjat "a", "c" dhe "ç" jepen gjoba nga 5 000 deri në 10 000 lekë.

b) Për shkeljet e parashikuara në nenin 8 shkronja "b" jepen gjoba nga 3 000 deri në 5 000 lekë.".

Neni 3

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 10

Ndaj vendimit të veterinarit zyrtar mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

Ekzekutimi i masës administrative bëhet në favor të Buxhetit të Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.".

Neni 4
Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në

krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 8025, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani